



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 38.

Prishtinë, më 16.04.2019, në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Haxhi Shala, Albert Kinolli, Muferra Shinik, Slobodan Petroviç. Duda Balje dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Igor Simiq, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljeviq, Zoran Mojsilović dhe Rasim Selmanaj.

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetovic OSBE; Nexhmie Hyseni EO; Ilir Hoxha KDI; Zijush Ahmeti KSZ dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, zëvendëskryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë, 26.02.2019, 7.03.2019 dhe 28.03.2019;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-101 për të Drejtën Ndërkombëtare Private, me raport amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, me raport amendamente të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Zëvendëskryetari, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë, 26.02.2019, 7.03.2019 dhe 28.03.2019.

Zëvendëskryetari, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me 26.02.2019, 7.03.2019 dhe 28.03.2019, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-101 për të Drejtën Ndërkombëtare Private, me raport amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Zëvendëskryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-101 për të Drejtën Ndërkombëtare Private, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-101 për të Drejtën Ndërkombëtare Private, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, me raport amendamente të Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione.

Zëvendëskryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit, të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, komisioni nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend.

5. Të ndryshme.

Zëvendëskryetari, ua dha fjalën për diskutim, anëtarëve të komisionit.

Veton Berisha, theksoi se si komision jemi të obliguar ti përmbahemi detyrave të caktuara në bazë të Planit të Punës, për vitin 2019. Sipas këtij dokumenti, një ndër përgjegjësit tona është që fillojmë me procedurat e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve.

Fillimisht propozoi, të ftohet në Komision, ministri për Zhvillim Rajonal z. Rasim Demiri, i cili është përgjegjës që të raportojë për programin e investimeve kapitale dhe procesin e menagjimit të subvencioneve dhe grandeve.

Si çështje tjetër, të ftohet në takim drejtori i zyrës për çështje të komunitete pran zyrës së Kryeministrit, që të raportojë për zbatimin e kornizës ligjore dhe menaxhimi i fondit, që janë në interes të komuniteteve.

Të përsëritet ftesa, për ministrin për Komunitete dhe Kthim z Jevtiq, lidhur me raportimin për çështjet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e tij. Për shkak të shembujve të mosbashkëpunimit, ai propozoi që të formohet një Komision hetimor, ku temë diskutimi do të jetë, kontrolli i veprimtarisë së përgjithshme, dhe shpenzimet e mjeteve buxhetore të kësaj Ministrie.

Dje isha në një takim me kryeministrin e Maqedonisë, ku kemi zhvilluar biseda për problematikat e refugjatëve, të cilët ende jetojnë në Maqedoni. Lidhur me këtë çështje, ekziston baza ligjore, andaj kërkojmë të gjendet një zgjidhja për kthimin e refugjatëve në Kosovë.

Në kuadër të 20 qershorit, ditës Ndërkombëtare të refugjatëve, duhet të ndërmerret veprim i përbashkët me Kryeministrin, që t'ju sigurohet kthimi i qëndrueshëm refugjatëve dhe të ndërmerren mekanizma për të ndihmuar integrimin në kushte të barabarta për të gjitha komunitetet dhe pjesëtarëve të tyre, me qëllim që të jetojnë dhe veprojnë si çdo qytetar i Kosovës.

Zëvendëskryetari, e mbështet propozimin e dhënë të anëtarit Z. Berisha, që të ftohet në raportim ministri Z. Jevtiq. Ishte i mendimit që përpjekjet për vendosjen e bashkëpunimit reciprok, koordinimit dhe marrëveshjeve të përbashkëta të Komisionit dhe kësaj Ministrie, rezultuan të pasuksesshme. Për zgjidhjen e këtij problemi duhet t'i qasemi në mënyrë të përgjegjshme, me qëllim të përmbushjes të obligimeve të tija.

Me qëllim të realizimit të aktiviteteve të Planit të Punës, kam propozuar disa herë të vizitohet KK në Zubin Potok, mirëpo kjo vizitë nuk është realizuar për arsye të angazhimeve të anëtarëve të komisionit. Ai përsëriti kërkesën e njëjte, që Komisioni në përbërje të plotë të vizitojë KK të Zubin Potokut.

Anëtarët e Komisionit u akorduan që stafi mbështetës i Komisionit me përkrahje të OSBE-së, të organizojë vizitën në Zubin Potok, në muajin maj të këtij viti.

Danush Ademi, sa i përket aktiviteteve dhe përgjegjësive të cilat i takojnë ministritë për Komunitete dhe Kthim, kamë vërejtje të shumta, të cilat i kam ngritur edhe në Kuvend. Ai diskutoi se në vitin 2019, ministria për Punë dhe Mirëqeni Sociale ka ndarë një fond prej 2.500,00 euro për ndërtimin e shtëpive për komunitetet joshumicë, jo serbe.

Sa i përket procesit të refugjatëve të cilët jetojnë në Maqedoni, tha se atyre, pas 20 vjetësh ju takon e drejta të marrin nënshtetësinë maqedonase. Kam informacione, se një numër i madh i tyre është kthyer në Kosovë.

Ai hapi si problem, rastin e kthimit të familjeve me dhunë nga shtetet perëndimore, siç janë: Gjermania, Holanda, Zvicra dhe Suedia. Ministria për Komunitete dhe Kthim, është deklaruar se ka program vetëm për refugjatët të cilët kthehen nga Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia, ndërsa nuk kanë paraparë program për kthimin e refugjatëve nga vendet e treta.

Tani ekziston një procedurë tjetër, është ndarë një fonde në Ministrinë për Integritime Evropiane, për ndërtim dhe grande të ndryshme, ku përfitues janë familjarët të cilët kthen nga vendet e treta. Në këto raste, familjarët duhet ti dorëzojnë aplikacionet në zyrat lokale për komunitete, të cilat dokumente përcillen në Ministrinë për Punë të Brendshme, dhe kjo ministri me anët të programeve të tyre, të njejtat i dërgon në Ministrinë për Integritime Evropiane.

U ndërlidh se në vitin 2018, kanë qenë përfituese vetëm dy familje. Mungojnë informacionet për të aplikuar me kohë, dhe kjo është arsya e mungesës së rezultateve të duhura.

Albert Kinolli, ai ngriti dy çështje, së pari, diskutoi se nuk pajtohet me pasivitetin e ministritë për Komunitete dhe Kthim, me arsye q i njëjti të ndikojë në punën tonë. Kjo ministri nuk varet vetëm nga një person, nga se ka zëvendësministra, sekretarin e përgjithshëm. Për këtë arsye, mirë është që komisioni të vizitojë këtë ministri, me qëllim të marrjes së informacioneve të nevojshme.

Sa i përket procesit të kthimit të refugjatëve, mund të them, se liria e lëvizjes garantohet me ligj.

Si proces tjetër me rëndësi është procesi i ri integritetit të personave të riatdhesuar. Ky proces tani është decentralizua dhe komunat merren me personat e kthyer nga vendet e treta.

Lidhur me këtë çështje, procedurat fillojnë nga zyra për çështje të komuniteteve pran zyrës së Kryeministrit, ndërsa fondi ndahet nga Ministria për Punë të Brendshme. Kjo Ministri, për 6 muaj paguan qiranë dhe veshmbathje për këto familje. Ai potencoi, se i mirëpresim refugjatët të cilët kanë vullnet të mirë të kthehen nga Serbia, Mili i Zi apo Maqedonia.

Duda Balje, diskutoi lidhur me mos përgjegjësin e ministrit z. Dalibor Jevtiq, i cili e bojkoton punën, mirëpo përgjegjësia e tij është ti përmbush obligimet, të cilat janë në interes të komuniteteve. Sa i përket monitorimit të punës së kësaj ministrie, u deklarua se pajtohet të jetë anëtare e grupit punues.

Zëvendëskryetari, propozoi të formohet grupi punues, me qëllim të mbikëqyrjes së veprimtarisë së përgjithshme të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe kontrollin buxhetor lidhur me mjetet e shpenzuara. Në kuadër të gjeturave, mund të dalim me raport i cili do të ndikojë në koordinimin e politikave në nivel qendror dhe lokal si dhe çështjet tjera që janë në interes të komuniteteve.

Anëtarët e komisionit, propozuan të formohet grupi punues, me këtë përbërje: Duda Balje, Veton Berisha, Danush Ademi, Albert Kinolli dhe Haxhi Shala.

Pas diskutimeve, Komisioni murr qëndrim të hartohet si pikë e veçanta e rendit të ditës; Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Zëvendëskryetari, theksoi se gjatë takimit me datë 5.4.2019, të mbajtur me ministrin e Punëve të Brendshme z, Ekrem Mustafa, ndër temat tjera është diskutuar edhe rasti i incidenteve ndëretnike, ndërsa, ky fakt është mohuar nga Ministri dhe drejtori i policisë. Lidhur me këtë temë, LS deklarohet se ndodhin incidente të shumta në komuna të banuara me përfaqësues të komunitetit të tyre.

Në bazë të diskutimit, ai propozoi që të ftohet në Komision, Ministrin z. Mustafa dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë z. Qelaj, me qëllim që të raportojnë për sigurinë në Kosovë dhe rastet e incidenteve me motiveve ndëretnike.

Pas konsultimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nori këtë:

Përfundim

Ngarkohet administrata për mbështetje të Komisioneve, me datë 24.04.2019, të ftojë në takim ministrin e Ministrisë për Punë të Brendshme z. Mustafa dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë z. Qelaj, me qëllim të raportimit për gjendjen e sigurisë në Kosovë, dhe incidentet që kanë motive ndëretnike.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

Përgatitur nga; Njësia mbështetëse e Komisionit

Zëvendëskryetar i Komisionit

Xhelal Sveçla